



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I EDUKIMIT

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
 Tel: +383 38 229 201 • E-mail: edukimi@uni-pr.edu • edukimi.uni-pr.edu

Tezat e masterit për diskutim publik të miratuara nga Departamenti i Mësimdhënies Lëndore

Me datë 27.4.2021

Vendimet për DISKUTIM PUBLIK					
#	Kandidati	Specializimi	Tema e punimit	Komisioni	
1	Eda Agushi	Mës. Tekn.TIK	Efekti përdorimit të platformës Canvas për ndërveprimin mësimdhënës-nxënës	Kryetar/e	Kastriot Buza
				Mentor/e	Sylejman Berisha
				Anetar/e	Florent Bunjaku
2	Jeton Selimi	Mës. Tekn.TIK	Përdorimi i Google Sites dhe aplikacioneve interaktive në procesin mësimor	Kryetar/e	Kyvetë Shatri
				Mentor/e	Sylejman Berisha
				Anetar/e	Rozafa Ferizi
3	Alban Ahmetaj	Mës. Fizikë	Ndikimi i detyrave të shtëpisë në mësimnxënien e Fizikës	Kryetar/e	Minevere Rashiti
				Mentor/e	Zeqri Shaqiri
				Anetar/e	Sadik Bektashi
4	Saranda Kryeziu - Oruqi	Mës. Biologji	Zbatimi i ushtrimeve dhe punëve laboratorike në mësimin e biologjisë në sh.m.u.	Kryetar/e	Islam Kraniqi
				Mentor/e	Ruzhdi Kuqi
				Anetar/e	Valbona Berisha
5	Burim Krasniqi	Mës. Kimi	APLIKIMI I TEKNOLOGJISË INFORMATIVE (TIK-UT) NË MËSIMDHËNIEN DHE TË NXËNIT E ELEMENTEVE KIMIKE TË SISTEMIT PERIODIK	Kryetar/e	Arlinda Damoni
				Mentor/e	Islam Kraniqi
				Anetar/e	Kyvetë Shatri
6	Xhemile Aliu	Mës. Kimi	Motivimi i nxënësve nga ana e mësimdhënësve në rritjen e performancës në mësim nga lënda e kimisë	Kryetar/e	Sylejman Berisha
				Mentor/e	Islam Kraniqi
				Anetar/e	Teuta Danuza
7	Bedrije Kurti	Mës. Kimi	Ndikimi i mësimdhënies së bazuar në demonstrime në rezultatet e të nxënësve në lëndën e kimisë	Kryetar/e	Arlinda Damoni
				Mentor/e	Islam Kraniqi
				Anetar/e	Demë Hoti
8	Mjellma Rexhepi	Mës. Matematikë	Dallimet në perceptimin e faktorëve të arritshmërisë në matematikë sipas gjinisë, suksesit dhe moshës të nxënësve të ShML	Kryetar/e	Fahri Marevci
				Mentor/e	Valbona Berisha
				Anetar/e	Arlinda Beka
9	Afrije Jakupi	Mës. Kimi	Efikasiteti i punës mësimore në grupe në lëndën e fizikës në shkollën e mesme të ulët	Kryetar/e	Zeqri Shaqiri
				Mentor/e	Islam Kraniqi
				Anetar/e	Demë Hoti
10	Ali Kryeziu	Mës. Gjeografi	VLERËSIMI ME TESTE NË FUNKSION TË MOTIVIMIT TË NXËNËSVE NË TË NXËNIT E LËNDËS SË GJEOGRAFISË	Kryetar/e	Ethem Çeku
				Mentor/e	Bahtije Gërbeshi
				Anetar/e	Vlora Sylaj

11	Hyrishahe Keka- Nevzati	Mës. Gjeografi	Roli i mësimdhënies së gjeografisë në arritjen e kompetencave të nxënësit në shkollat e mesme të ulëta	Kryetar/e	Ethem Çeku
				Mentor/e	Bahtije Gërbeshi
				Anetar/e	Rozafa Ferizi
12	Fatbardha Neziraj	Mës. Biologji	Efekti i aktiviteteve të kombinuara mësimore në përvetësimin e rezultateve të të nxënësve të biologjisë në klasën e shtatë	Kryetar/e	Valbona Berisha
				Mentor/e	Ruzhdi Kuqi
				Anetar/e	Jehona Ferizi
13	Fatbardha Behrami	Mës. Histori	PUNA ME PROJEKTE NË LËNDËN E HISTORISË DHE VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE	Kryetar/e	Bahtije Gërbeshi
				Mentor/e	Ethem Çeku
				Anetar/e	Demë Hoti
14	Ardione Gaxhiqi	Mës. Histori	SHFRYTËZIMI I BURIMEVE PRIMARE DHE SEKONDARE NË TRAJTIMIN E PËRMBAJTJEVE TË HISTORISË NË TEKSTET MËSIMORE TË KLASAVE V-IX TË SHFMU	Kryetar/e	Bahtije Gërbeshi
				Mentor/e	Ethem Çeku
				Anetar/e	Demë Hoti

Kandidati/ja: 1. Eda Agushi

Tema: Efekti përdorimit të platformës Canvas për ndërveprimin mesimdhënës-nxënës

ABSTRAKTI

Synimi i këtij hulumtimi është që të tregoj rolin e përdorimit të platformës “Canvas” për sistemin e menaxhimit të mësimin në procesin e mesimdhënies dhe mesimnxënies. Krijimi i klasave virtuale nëpër platforma të ndryshme u jep mundësinë mesimdhënësve dhe nxënësve që të kenë qasje aktive në çdo kohë dhe kudo vetëm duke pasur qasje në internet.

Menaxhimi i mësimin në internet duke përdorur platforma të ndryshme po përdoret në mënyra të shumta në fushën e arsimit, të tilla si regjistrimi në klasën e krijuar nga mesimdhënësi, dhënia e përmbajtjes, menaxhimi i kursit, vlerësimi, raportimi dhe ruajtja e të dhënave. Platforma Canvas ofron një sistem të menaxhimit të mësimin që është krijuar për nxënës, studentë, mesimdhënës, instruktorë dhe institucione në mënyrë që të shfrytëzojë mundësitë që na jep platforma Canvas për zhvillimin profesional dhe zhvillimin e mësimin në distancë në të gjithë botën.

Qëllimi i këtij hulumtimi është për të parë efektin e përdorimit të platformës Canvas si sistem të menaxhimit të mësimin në distancë, si dhe ndikimin e tij për ndërveprimin mes mesimdhënësve dhe nxënësve. Me rezultatet që u nxorren nga ky hulumtim është parë se sa kishte ndikim pozitiv përdorimi i klasëve të krijuara në mënyrë virtuale për menaxhim të mësimin në distancë.

Hulumtimi është realizuar me anë të metodologjisë sasiore dhe cilësore. Për mbledhjen e të dhënave janë përdorur pyetësorët që janë përpiluar për nxënësit dhe intervistat për mesimdhënësit e shkollës së mesme të mjekësisë “Rezonanca” dhe shkollës së mesme të mjekësisë “Ali Sokoli” në Prishtinë. Numri i nxënësve që janë përfshirë për pyetësorë është 100 nxënës, 50 nxënës nga një shkollë dhe 50 nga shkolla tjetër, të 4 klasëve të ciklit të mesëm të lartë. Për intervista janë përfshirë 4 mesimdhënës, 2 nga një shkollë dhe 2 nga shkolla tjetër, të zgjedhur për kryerjen e hulumtimit. Nga ky hulumtim, kemi vërtetuar se platforma Canvas ka efekt ndërveprues mes mesimdhënësve-nxënësve.

Fjalët kyçe: Canvas, LMS, Ndërveprim, Platformë

Kandidati/ja: 2. Jeton Selimi

Tema: Përdorimi i Google Sites dhe aplikacioneve interaktive në procesin mësimor

ABSTRAKTI

Ky hulumtim fokusohet në përdorimin e Google Sites dhe platformave interaktive në edukim dhe ndikimin e tyre tek nxënësit e nivelit të mesëm shkollor në komunën e Gjilanit, gjatë periudhës së pandemisë të quajtur Covid-19.

Tani, në institucionet shkollore ka filluar zbatimi i mësimit elektronik dhe shfrytëzimi i websiteve dhe platformave të ndryshme elektronike, të cilat u mundësojnë mësimeve dhe nxënësve qasje nga distanca në mënyrë virtuale, pa pasur nevojë të vijojnë mësimin në objektet shkollore.

Përdorimi i websiteve në arsim gjegjësisht platforma Google Sites i ndihmon nxënësit dhe mësimeve në aspekte të ndryshme, duke ju ofruar një formë tjetër të mësimit, nëpërmjet interaktivitetit apo bashkëpunimit mes mësimeve dhe nxënësve dhe duke lehtësuar punën e tyre gjatë kohës së pandemisë, për t'i motivuar nxënësit që të jenë aktivë dhe kreativë, në mënyrë që nxënësit të mos largohen nga procesi i rregullt mësimor.

Në këtë hulumtim kemi shtjelluar më gjerësisht përdorimin e Google Sites dhe rëndësinë e tij në mësimeve dhe nxënie, pastaj integrimin dhe përdorimin e platformave interaktive në Google Sites dhe vlerësimin e nxënësve nga distanca.

Ky hulumtim është i natyrës sasiore dhe cilësore ndërsa si instrumente matëse kemi përdorur pyetësoren për nxënës dhe intervistën për mësimeve në dy institucione shkollore, nga SHFMU "Ramiz Cërrnica" dhe SHFMU "Rexhep Elmazi", në komunën e Gjilanit, ndërsa mostrën e përbëjnë tetë klasë të nënta me 130 nxënës dhe 5 mësimeve të lëndës së TIK-ut për të parë përdorimin e Google Sites dhe të platformave interaktive në edukim.

Nga hulumtimi kemi nxjerr rezultate në përdorimin e Google Sites dhe platformave interaktive në edukim gjatë periudhës së pandemisë dhe efektet e përdorimit të tyre gjatë realizimit të mësimit elektronik nga distanca. Gjithashtu kemi bërë krahasimin e rezultateve të arritura nga të dy institucionet shkollore.

Fjalët kyçe: *Google Sites, platformat interaktive, mësimi elektronik, mësimeve, të nxënësve.*

Kandidati/ja: 3. Alban Ahmetaj

Tema: Ndikimi i detyrave të shtëpisë në mësimnxënien e Fizikës

ABSTRAKTI

Punimi i këtij hulumtimi me titull “Ndikimi i detyrave të shtëpisë në mësimnxënien e Fizikës në shkollën e mesme të lartë” ka të bëjë me përpjekjet për të analizuar ndikimin e detyrave të shtëpisë në mësimnxënien e Fizikës. Detyrat e shtëpisë janë çështje e vlefshme për t’u diskutuar pasi që shumë mësime të mësuara i përdorin ato shumë shpesh dhe shumica prej tyre janë të vetëdijshëm për përdorimin, rëndësinë, dhe ndikimin e tyre.

“ Mësimdhënia e sotme, si rezultat i zhvillimit të shpejt dhe shpërthimit të informacionit, synon në zhvillimin e shprehive të menduarit të nivelit të lart dhe zgjidhjes së problemit”(Musai,2003).

Qëllimi kryesor i hulumtimit ishte : Të identifikojmë ndikimin e detyrave të shtëpisë në mësimnxënien e Fizikës me nxënësit e gjimnazeve “Haxhi Zeka” në komunën e Istogut, “Frang Bardhi” në komunën e Mitrovicës, si dhe “ Hamëz Jashari” në komunën e Skënderajt.

Çdo mësime të mësuara për të realizuar një orë mësimore sa më efektive dhe për të arritur efikasitetin e saj mund dhe duhet të përzgjedh atë metodë që është më e përshtatshme dhe më e lehtë për nxënësit. Prandaj, mund të thuhet që detyrat e shtëpisë janë lehtësuese për të kuptuarit më të mirë të lëndës.

Mbledhjen e informacioneve të këtij hulumtimi e kam realizuar me nxënësit e shkollave të mesme të larta në komunën e Istogut, Mitrovicës dhe Skënderajt, ndërsa rezultatet e këtij hulumtimi ishin fitimprurëse për mësime të mësuara të Fizikës, nxënësit e tanishëm dhe të ardhshëm dhe çdo njërin që dëshiron të mësojë lëndën e Fizikës.

FJALËT KYÇE : Madhësitë fizike ,njësitë matëse, vlerat numerike, metodologjia e punës.

Kandidati/ja: 4. Saranda Kryeziu –Oruqi

Tema: Zbatimi i ushtrimeve dhe punëve laboratorike në mësimin e biologjisë në sh.m.u.

ABSTRAKTI

Ushtrimet dhe punët laboratorike mund të bëhen sipas modeleve dhe mënyrave të ndryshme të zgjedhura, bazuar në qëllimet specifike të të nxënit. Mësimi praktik i është dhënë një rol qendror dhe dallues në edukimin shkencor, dhe arsimtarët e shkencës kanë sugjeruar që ka përfitime të pasura në të mësuarit nga përdorimi i aktiviteteve laboratorike. Në këtë kohë, megjithatë, disa arsimtarë kanë filluar të vënë në dyshim seriozisht efektivitetin dhe rolin e punës laboratorike, dhe çështja për mësimdhënien laboratorike nuk është aq e vetëkuptueshme sa dukej dikur. Ky punim ofron perspektiva mbi këto çështje përmes një rishikimi të qëllimeve dhe gjetjeve të hulumtimit në lidhje me mësimin praktik dhe eksperimental që zbatohet në shkollë, laboratorin si një mjet udhëzimi në mësimin hyrës shkencor. Analiza e kërkimit në këtë hulumtim arrin kulmin me sugjerime për studiuesit që po punojnë për të sqaruar rolin e mësimi praktik dhe laboratorit në edukimin shkencor.

Në këtë punim do të shqyrtohet zbatimi i ushtrimeve dhe i punimeve laboratorike gjatë mësimdhënies së lëndës së biologjisë krahas metodave teorike, sa janë të pajisura shkollat me laboratore dhe mjete laboratorike. Ky hulumtim do të ndihmojë në identifikimin e vështirësive që hasin mësimdhënësit e biologjisë në zbatimin e ushtrimeve dhe punëve laboratorike për realizimin dhe efikasitetin e tyre në orët e biologjisë.

Rezultatet e këtij hulumtimi do të kontribuojnë në nxjerrjen në pah të anëve pozitive dhe negative që kanë ushtrimet dhe punët laboratorike në shkollë si dhe ndryshimet që duhet bërë për një mësimdhënie dhe mësimnxënie sa më cilësore.

Fjalë kyçe: demonstrim, laborator, mjete laboratorike, punë praktike, ushtrime etj.

Kandidati/ja: 5. Burim Krasniqi

Tema: APLIKIMI I TEKNOLOGJISË INFORMATIVE (TIK-UT) NË MËSIMDHËNIEN DHE TË NXËNIT E ELEMENTEVE KIMIKE TË SISTEMIT PERIODIK

ABSTRAKTI

Tema që kam zgjedhur të trajtoj ka një rëndësi të veçantë, pasi synon rritjen e cilësisë së mësimdhënies duke dhënë informacion të detajuar lidhur me teknologjinë e informacionit, si një tendencë e re që po përdoret edhe nga mësuesit. Ky punim do të paraqesë një tablo të qartë të situatës së mësimdhënies me integrimin e TIK-ut, konkretisht në lëndën e Kimisë. Punimi ndahet në katër kapituj, ku në kapitullin e parë do të jepet përcaktimi i teknologjisë së informacionit dhe përdorimi i saj në mësimdhënie. Në vazhdim të këtij kapitulli do të flas për rëndësinë e përdorimit të TIK-ut në mësimdhënie, avantazhet dhe disavantazhet e saj. Në kapitullin e dytë do të paraqiten metodat bashkëkohore të mësimdhënies dhe mënyrat e integritit të teknologjisë informative të komunikimit, duke u fokusuar edhe në metodat mësimore TIK që zbatohen mësuesit gjatë mësimin. Kapitulli i tretë do të trajtojë gjerësisht përdorimin e teknologjisë në lëndën e Kimisë, duke përmendur disa nga arsyet e përdorimit të teknologjisë në klasë si dhe format e përfshirjes së TIK në lëndën e Kimisë. Në një çështje të këtij kapitulli do të përpiqem t'i jap përgjigje pyetjes: Si duhet të përdoret teknologjia në procesin mësimor për të arritur rezultatet e dëshiruara mësimore? Më pas do të ndalem tek roli i ri i mësuesit dhe impakti i TIK-ut në mësimdhënien e lëndës së Kimisë, me fokus të veçantë tek aplikimi i teknologjisë së informacionit në mësimdhënien dhe nxënien e sistemit periodik të elementëve. Kapitulli i katërt dhe i fundit përmban pyetësin dhe analizën e tij. Pyetësi që është bazë e këtij punimi lidhet me “Efektet e aplikimit të teknologjisë së informacionit gjatë mësimdhënies të elementëve kimike të sistemit periodik.” Pyetësi iu është drejtuar 40 nxënësve të dy klasave të shtata të shkollës SHFMU “Afrim Buqaj” - Lladroc, duke u përpjekur të kuptojmë rëndësinë që ka përdorimi i teknologjisë së informacionit në procesin e të nxënësve tek nxënësit. Më pas do të analizoj pyetësit teorikisht dhe grafikisht, duke bërë të mundur edhe krahasimin e rezultateve për të dy grupklasat. Së fundi, kam paraqitur të gjitha konkluzionet dhe rekomandimet e punimit.

Fjalët kyçe: *metoda mësimdhënie, nxënie, sistemi periodik, teknologji informacioni*

Kandidati/ja: 6. Xhemile Aliu

Tema: Motivimi i nxënësve nga ana e mësimit në rritjen e performancës në mësim nga lënda e kimisë

ABSTRAKTI

Ky punim fokusohet në rëndësinë e madhe që ka motivimi si proces në mësimnxënien e lëndës së Kimisë. Menaxhimi i motivimit ka të bëjë me drejtimin, organizimin e veprimtarive të tilla të nxënësve duke synuar që maksimalizohet përfshirëja produktive e nxënësve në mësim. Është e rëndësishme të theksojmë se motivimi i nxënësve fillon me zhvillimin e ndërtimit të besimit dhe marrëdhënieve midis nxënësve dhe mësimit.

Qëllimi i studimit është të hulumtojë arritjen e motivimit të nxënësve nga ana e mësimit në rritjen e tyre, si dhe sa është produktiv ky motivim tek nxënësve për të rritur performancën në lëndën e kimisë.

Hulumtimi është realizuar përmes pyetësorëve, që është një metodë e përshtatshme për grumbullimin e të dhënave dhe për të nxjerrë rezultate të përgjithshme. Pyetësorët janë hartuar për mësimit dhe për nxënësve të shkollës “Xhemajl Mustafa” në komunën e Prishtinës.

Të dhënat nga ky hulumtim pritet të paraqesin një kontribut mbi gjendjen aktuale lidhur me motivimin e nxënësve nga ana e mësimit në mënyrë që të rrisin performancën e tyre në lëndën e Kimisë.

Nga hulumtimi jonë shohim që disa nga metodat me të cilat mësimit mundohen t'i motivojnë nxënësve të tyre janë duke bërë eksperimente të ndryshme interesante si dhe duke gjetur mënyrën e duhur për t'ua shpjeguar lëndën e kimisë. Gjithastu mund të shohim që mësimit kanë raporte shumë të mira me nxënësve të tyre. Pjesa më e madhe e mësimit mendojnë që lënda e kimisë ka lidhje edhe me jetën e përditshme. Poashtu, mund të shohim që pjesa më e madhe e mësimit i dërgojnë nxënësve të tyre në laboratorët e shkollës. Sa i përket rezultateve nga pyetësori me nxënësve shohim që pjesa më e madhe e nxënësve kanë thënë që lënda e kimisë nuk është lënda e tyre e preferuar. Nxënësve kanë thënë që bashkëpunojnë me mësimit për çfarëdo vështirësi që kanë.

Fjalët kyçe: Motivimi, mësimit, nxënësve, performance, lënda e Kimisë.

Kandidati/ja: 7. Bedrije Kurti

Tema: Ndikimi i mësimdhënies së bazuar në demonstrime në rezultatet e të nxënit në lëndën e kimisë

ABSTRAKTI

Ky hulumtim ka analizuar ndikimin e mësimdhënies së bazuar në eksperimente në shkollën fillore të mesme të ulët “Ismajl Qemajli” dhe në shkollën fillore dhe të mesme të ulët “Afrim Abazi” të komunës së Ferizajt me klasët e VIII-ta për të identifikuar njohurit e nxënësve rreth punës praktike eksperimentale si dhe marrjen e informatave rreth praktikimit të eksperimenteve në shkolla.

Përdorimi i mjeteve të ndryshme praktike, eksperimentale nga mësimdhënësi i nxitë dhe motivon nxënësit duke i shtyrë ata drejt të nxënit efikas, të menduarit logjik dhe kreativ. Mbledhja e të dhënave në realizimin e këtij hulumtimi i takojnë metodës së përzier, pra asaj sasiore dhe cilësore. Instrumentet e hulumtimit janë: intervistat me mësimdhënës të lëndës së kimisë, pyetsorët me nxënës, para testi, pas testi dhe lista e vëzhgimit.

Hulumtimi është realizuar në shkollën fillore të mesme të ulët “Ismajl Qemajli” dhe në shkollën fillore dhe të mesme të ulët “Afrim Abazi” të komunës së Ferizajt me klasët e VIII-ta, ndërsa të dhënat janë marrë nga dy klasë me nga 22-së nxënës.

Klasa e VIII- 1 (SHFMU “Afrim Abazi”), ka qenë klasë kontrolli, ndërsa klasa VIII- 2 (SHFMU “Ismajl Qemali”) klasë eksperimentale.

Nga rezultatet e e nxjerra nga ky studim tregojne se nxënësit e përfshirë në zhvillimin e njëjësive mësimore përmes eksperimenteve, aktiviteteve dhe punës praktike të zhvilluara në laborator me shembuj konkret ndikon në rritjen e rezultateve të të nxënit e nxënësve në lëndën e kimisë në krahasim me nxënësit të cilët njësit mësimore i realizojnë pa u përfshirë pjesa praktike, laboratorike por vetëm ana teorike.

Të dhënat e fituara nga pyetësorët janë analizuar me metoda statistikore përmes programit SPSS, diagramet janë nxjerrë përmes programit Excel, ndërsa analiza cilësore e intervistave është bërë me metodën induktive.

Fjalët kyçe: Ndikim, eksperiment, mësimdhënie, nxënie, kimi.

Kandidati/ja: 8. Mjellma Rexhepi

Tema: Dallimet në perceptimin e faktorëve të arritshmërisë në matematikë sipas gjinisë, suksesit dhe moshës te nxënësit e ShML

ABSTRAKTI

Ky hulumtim fokusohet në analizën e perceptimeve të nxënësve të shkollës së mesme të lartë mbi faktorët që ndikojnë në arritjet në lëndën e matematikës. Vështrim i posaçëm i drejtohet variabilitetit të perceptimeve të nxënësve në varësi të gjinisë, suksesit, moshës (klasës) dhe llojit të shkollës që nxënësit vijojnë. Qëllimi i hulumtimit është i dyfishtë: (1) përcaktimi i shkallës së ndikimit të faktorëve individual dhe grup-faktorëve në arritshmërinë në matematikë sipas mendimit të nxënësve, (2) përcaktimi i variabilitetit në perceptim ndërmjet grupeve të nxënësve. Hulumtimi është zhvilluar në të gjitha llojet e shkollave të mesme të larta në Kosovë. Si instrument për grumbullimin e të dhënave është përdorur një pyetësor i ndërtuar enkas. Pyetësori përmban 32 faktorë individual të cilët ndërtojnë katër grup-faktorë (kategori). Alfa e Cronbach-ut është shfrytëzuar për përcaktimin e besueshmërisë së instrumentit hulumtues. Analiza e rezultateve është bërë duke përdorur dy metoda statistike të modelimit të përgjithshëm linear - ANOVA dhe MANOVA - që mundësuan shqyrtimin e relacioneve ndërmjet variablave. Të gjeturat na ofruan një pasqyrë të kompletuar e të hollësishme të nuansave të perceptimeve të studiuara. Sipas mendimeve të nxënësve, radhitja e katër grup-faktorëve sipas relevancës është: mësimdhënësi, nxënësi, shkolla, familja. Sa i përket variabilitetit të përgjigjeve sipas grupeve të nxënësve, dallime statistikisht domethënëse ka në relacion me gjini, sukses dhe moshë (klasë), ndërsa nuk ka në relacion me llojin e shkollës. Përfundimet më relevante nga analiza e integruar përmes MANOVA dhe ANOVA janë: (1) vajzat krahasuar me djemtë mendojnë se faktori nxënës është më relevant në arritjet matematike, prandaj mund të thuhet se vajzat janë më të gatshme të marrin përgjegjësi individuale në këtë rast (2) duke u rritur me moshë nxënësit besojnë se familja ka rol më të madh në arritjet e tyre matematike (3) rolin e mësimdhënësit e theksojnë më së shumti nxënësit e klasës së XI (4) nxënësit që kanë nota më të ulta në matematikë, rolin e familjes e shohin më të madh. (5) nxënësit që kanë nota më të larta në matematikë faktorin nxënës e shohin më relevant.

Fjalët kyçe: Faktorët e arritshmërisë, matematika, nxënësit, shkolla e mesme e lartë.

Kandidati/ja: 9. Afrije Jakupi

Tema: Efikasiteti i punës mësimore në grupe në lëndën e fizikës në shkollën e mesme të ulët

ABSTRAKTI

Ndryshimi i sistemit të arsimit nga ai tradicional në atë bashkëkohor dhe metodologjia e re në arsim që ka për qëllim zhvillimin sa më të suksesshëm në sistemin e arsimit, mendojmë se ju sjellin dyshime mësimdhënësve mbi mësimdhënien dhe mësimnxënien.

Paqartësitë kanë të bëjnë me:

- Ndryshimet e plan-programeve dhe kurrikulës së re;
- Ndryshimi i teksteve shkollore;
- Teknologjia e re e informacionit në arsim
- Përgatitja shkencore dhe metodologjike e mësimdhënësve etj.

Këto ndryshime kanë ngritur shqetësime te mësimdhënësit dhe kanë nxitur mësimdhënësit dhe teoricienët e pedagogjisë se si të arrijnë suksesin e merituar gjatë mësimdhënies në shkollë. Në këtë aspekt zbatimi i strategjive të reja në mësimdhënie dhe në mësimnxënie, dhe në këtë rast konkretisht puna në grupe po bëhet me qëllim që nxënësit të ndjehen më mirë gjatë procesit mësimor dhe në këtë aspekt t'i shprehin më lehtë idetë e tyre. Synimi është i qartë: nëpërmjet mësimdhënies të arrihet përvetësimi cilësor i kurrikulës shkollore, ndërsa objektivi i shkollës sonë është përgatitja e individit (nxënësit) për jetë më të mirë.

Kur kemi parasysh mendimet e ndryshme për zhvillimin e formës së punës në grupe, mendojmë se rëndësia e këtij punimit qëndron në atë, se në lidhje me efikasitetin e punës në grupe në lëndën e fizikës në shkollën e mesme të ulët, në vendin tonë nuk janë bërë hulumtime të mirëfillta, prandaj konsiderojmë se punimi ynë sadopak e jep një vlerësim të drejtë për këtë çështje. Në këtë aspekt janë paraqitur dyshime te mësimdhënësit, prindërit dhe nxënësit për efikasitetin që sjell puna në grupe, sepse disa mësimdhënës konsiderojnë se gjatë aplikimit të kësaj forme mësimore të punës, krijohet zhurmë në klasë, e cila e pengon procesin mësimor.

Disa nxënës punojnë në mënyrë aktive, ndërsa disa të tjerë mbesin pasiv dhe vetëm krijojnë zhurmë në klasë.

Duke u bazuar në praktikën tonë mësimore dhe në shumë të dhëna mendojmë se, hipoteza jonë “Forma mësimore puna në grupe në lëndën e fizikës, në shkollën e mesme të ulët është më efikase sesa format e tjera të punës mësimore”.

Hulumtimin e kemi realizuar përmes metodologjisë bashkëkohore që merret me studimet e zhvillimit të mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Hulumtimi është i natyrës empirike dhe është realizuar në lëndën e fizikës në shkollën e mesme të ulët. Hulumtimi ynë, paraqet një përpjekje shkencore për të vërtetuar efikasitetin e punës mësimore në grupe, në lëndën e fizikës.

Sa i përket pjesës teorike hulumtimi ynë është mbështetur në literaturën pedagogjike-didaktike, metodike dhe psikologjike, pastaj në fjalorët pedagogjik dhe në enciklopedinë pedagogjike. Po ashtu kemi kryer hulumtim në shkollë përmes anketës dhe intervistës dhe kemi vëzhguar nxënësit në klasa, të cilët kanë punuar në klasë eksperimentale dhe në klasë të rregullt, ku mësimdhënësi i tyre ka qenë i njëjtë.

Fjalët kyçe: Efikasitet, mësimdhënie, mësimnxënie, formë e punës, nxënës, mësimdhënës.

Kandidati/ja: 10. Ali Kryeziu

Tema: VLERËSIMI ME TESTE NË FUNKSION TË MOTIVIMIT TË NXËNËSVE NË TË NXËNIT E LËNDËS SË GJEOGRAFISË

ABSTRAKTI

Ky hulumtim tenton të identifikoj mënyrat se si mund të ndikojmë ne si mësimdhënës në motivimin e nxënësve që përmes testeve të nxënë lëndën e gjeografisë. Vlerësimi i nxënësve sipas kurrikulës lidhet me tërësinë e instrumenteve, teknikave, metodave, që përdorin mësimdhënësit për të kontrolluar dhe për të matur nivelin dhe cilësinë e njohurive, aftësive dhe të performancës së nxënësve. Mësimdhënësi e vlerëson nxënësin sipas instrumenteve të tij, por duhet ta gjejë instrumentin që i përshtatet nxënësit, dhe në këtë aspekt mësuesi duhet patjetër të reflektoj në rast se instrumentet që po i përdor nuk sjellin rezultate të pritura në të nxënët e nxënësve. Mësimdhënësi mund të nxjerrë rezultate të mira tek nxënësit përmes testeve, pasi dihet se ka shumë nxënës që janë më të aftë të shprehen përmes shkrimit se sa në mënyrë verbale.

Hipoteza kryesore e këtij hulumtimi është: Vlerësimi me teste ndikon pozitivisht në motivimin e nxënësve në të nxënët e lëndës së gjeografisë. Nënhipoteza është: Lloji i testit ndikon pozitivisht në rezultatet e nxënësve në kuadër të vlerësimit me teste, dhe nënhipoteza tjetër është: Vlerësimi përmes testit është ekonomik për mësimdhënësit.

Qëllimi i këtij hulumtimi ishte që të kuptojmë se sa mundemi ne si mësimdhënës t'i motivojmë nxënësit ta nxënë lëndën e gjeografisë duke i vlerësuar me teste, cilat lloje të testit i pëlqejnë më shumë nxënësve, cilat janë format e testit që i aplikojnë mësimdhënësit, sa ka rëndësi lloji i testit në rezultatet e nxënësve. Sa i përket metodologjisë kemi bërë një integrim të metodës kualitative dhe kuantitative, dhe si instrumente matëse në aspektin sasior kemi përdorur pyetësin dhe e kemi realizuar me 100 nxënës të klasës së VIII-të dhe 100 nxënës të klasës së IX-të, ndërsa në aspektin cilësor në këtë hulumtim kemi përdorur intervistën me mësimdhënësit. Intervista është realizuar me 10 mësimdhënës të lëndës së gjeografisë në shkollat e qytetit të Prishtinës.

Nga rezultatet e fituara nga ky hulumtim rezulton se pjesa dërmuese e nxënësve dhe mësimdhënësve të përfshirë në hulumtim kanë qëndrime pozitive për rëndësinë e testit në funksion të motivimit të nxënësve në të nxënët e lëndës së gjeografisë.

Fjalët kyçe: *Test, vlerësim, motivim, nxënie, mësimdhënie, nxënës, mësimdhënës.*

Kandidati/ja: 11. Hyrishahe Keka-Nevzati

Tema: Roli i mësimdhënies së gjeografisë në arritjen e kompetencave të nxënësve në shkollat e mesme të ulëta

ABSTRAKTI

Të nxiturit për një hulumtim të tillë shfaqet nga nevoja për orientimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies në zhvillimin e kompetencave në lëndën e gjeografisë në shkollat e mesme të ulëta. Pasi që zhvillimi i kompetencave është i kushtëzuar nga shumë faktorë, qëllimi i këtij hulumtimi ka të bëjë me vlerësimin dhe ofrimin e njohurive, si të arrihen kompetencat nga nxënësve nëpërmjet lëndës së gjeografisë. Me anë të shembujve do të demonstron arrijta dhe relacioni i rezultateve të kompetencës, si dhe lidhja e rezultateve të fushës kurrikulare, me rezultatet e të nxënësve për lëndë, si dhe lidhja e rezultateve të njësive mësimore dhe kriteret e suksesit, të cilat duhet të jenë sipas nivelit të Taksonomisë së Bloomit. Për të qenë në linjë me arrijten e kompetencave duhet synuar edhe konceptet e fushës kurrikulare Shoqëria dhe mjedisi, e në veçanti konceptet të cilat i përshtaten lëndës së gjeografisë si: proceset shoqërore dhe natyrore, mjedisi, resurset dhe zhvillimi i qëndrueshëm. Mësimdhënien e bazuar në kompetenca duhet mbështetur në qëllimet dhe parimet e arsimit parauniversitar, me çështjet ndërkurrikulare. Po ashtu, duhet përshtatur metodologjia, materialet mësimore, si dhe vlerësimi i nxënësve bazuar në njohuri dhe kompetenca. Pra, përmes këtij punimi, mësimdhënësve të lëndës së gjeografisë do t'u ofrohet material i cili do t'i ndihmon ata që mësimnxënien ta orientojnë në gjetjen e informacionit, vlera, qëndrime, shkathtësi dhe në formimin e shprehive të tyre. Mësimnxënien duhet orientuar në:

- Hulumtimin e proceseve natyrore dhe shoqërore-ekonomike dhe ndërvarësinë mes tyre;
- Vëzhgimet dhe punën në teren;
- Leximin dhe ndërtimin e grafikoneve, fotove, tabelave dhe hartave;
- Arsytimin në pabarazinë e shpërndarjes dhe të dendësisë së popullsisë;
- Në nxitjen e dhënies së ideve për çështje të caktuara në vend, rajon dhe botë.

Rezultatet e marra nga ky hulumtim tregojnë se lënda e gjeografisë kontribuon në arrijten e kompetencave. Numri më i madh i nxënësve dhe mësimdhënësve pohojnë se, ata më tepër përfitojnë me anë të ndërveprimit dhe se në këtë mënyrë mund t'i shprehin idetë, mendimet e tyre dhe të arrijnë t'i zotërojnë kompetencat.

Fjalët kyçe: kompetencë, mësimdhënie, të nxënësve, programi lëndor i gjeografisë

Kandidati/ja: 12. Fatbardha Neziraj

Tema: Efekti i aktiviteteve të kombinuara mësimore në përvetësimin e rezultateve të të nxënësve të biologjisë në klasën e shtatë

ABSTRAKTI

Edukimi në shoqërinë tonë është baza më e mirë për të përmirësuar jetën e një individi. Edukimi përmirëson njohuritë, aftësitë, zhvillon personalitetin dhe qëndrimin duke lejuar që të gjithë individët të mësojnë të jetojnë së bashku në paqe. Andaj krijimi i mjedisit stimulues duhet të jetë në përshtatshmëri me nevojat e nxënësve. Tema e këtij hulumtimi ka të bëjë me ndikimin e aktiviteteve të kombinuara brenda orës mësimore në përvetësimin e rezultateve të të nxënësve nga ana e nxënësve në lëndën e biologjisë. Ky hulumtim është sasior, hulumtimi u realizua në shkollën e mesme të ulët “Emin Duraku” në Kaçanik. Fillimisht u realizuan disa orë mësimore me njësi të cilat u korrespondojnë planit mujor dhe atij vjetor, me nxënës të klasave të shtatë, në gjatësi paralele me nga 30 nxënës. Në përfundim të njësive, nxënësve iu parashtrua një test në lidhje me njësitë që i kanë mësuar (pyetje nga lënda e biologjisë) ku në bazë të atyre rezultateve u vlerësua saktë se cilat njësi mësimore i kanë përvetësuar më mirë, ato ku kemi realizuar aktivitete të kombinuara apo ato të cilat janë realizuar me teknika të tjera. Të dhënat u analizuan me SPSS dhe u paraqiten në tabela dhe grafikone.

Strukura e këtij punimi kishte disa etapa të cilat janë të ndërlidhura dhe plotësojnë njëra-tjetrën duke aritur në rezultatet e fituara të cilat kompletojnë këtë punim: përmbledhja e asaj se çfarë u trajtua në këtë hulumtim, pastaj përmbledhja e kornizës teorike dhe literaturës relevante, metodologjia e hulumtimit, rezultatet e të dhënave empirike të hulumtimit, diskutimet dhe analizat e të dhënave dhe në fund konkludimet e nxjerrura nga ky hulumtim.

Si rezultate kyçe të hulumtimit vlerësojmë se ndikimi i aktiviteteve të kombinuara në orët mësimore të lëndës së biologjisë tek nxënës të klasëve të 7 ka ndikim të lartë në kuadër të nxënies së kësaj lënde. Po ashtu vlerësojmë se nxënës kishin njohuri më të mira tek njësitë ku u demonstruan me aktivitete më shumë se tek ajo ku u përdor metodologji tjetër e mësimdhënies.

Fjalët kyçe: Biologji, mësimdhënie, nxënës, përvetësim, rezultat i të nxënësve.

Kandidati/ja: 13. Fatbardha Behrami

Tema: PUNA ME PROJEKTE NË LËNDËN E HISTORISË DHE VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE

ABSTRAKTI

Historia është shkencë e cila merret me studimin dokumentimin të kaluarës dhe evidentimin e ngjarjeve të rëndësishme kohore të cilat kanë bërë kthesë apo kaheje të caktuar proceseve jetësore, politike e shoqërore. Si lëndë ajo është e pranishme nga fillet e edukimit të mesëm të ultë dhe paraqet një segment të rëndësishëm të formimit dhe plotësimit të nxënësve më njohuritë e duhura nga e kaluara qoftë kombëtare apo edhe ndërkombëtare.

Për një mësimdhënës të lëndës së historisë është shumë e rëndësishme mënyra e organizimit të një ore mësimore nëpërmjet strategjive dhe të ndryshme të strukturimit të një ore mësimore. Si një nga ecuritë është ajo përmes projekteve që realizohen për inkuadrimit të të gjithë nxënësve në funksion të arritjes së objektivave sa më cilësore për një temë të caktuar.

Nëpërmjet këtij punimi është synuar që të analizohet dhe të identifikohet vlerësimi në lëndën e historisë përmes projekteve si ecuri ndërvepruese.

Në hulumtim janë përfshihen gjithsej 200 nxënës të shkollave të mesme të ulëta në komunën e Skenderajt, ShFMU “Shotë Galica” në Runik, ShFMU “Shaban Jashari” dhe ShFMU “Ahmet Delia” në Skenderaj. Zbatimi i hulumtimit është bërë më aplikimin e një pyetësores më nxënësit e klasave të 8-ta dhe 9-ta në shkollat e lartë cekura. Pastaj të dhënat e grumbulluara do të procedohen në një databazë nga e cila janë nxjerrë rezultatet në formë grafike si dhe është bërë interpretimi narrativ i tyre.

Fjalët kyçe: *arritje, historia, nxënës, projektet, vlerësimi*

Kandidati/ja: 14. Ardione Gaxhiqi

Tema: SHFRYTËZIMI I BURIMEVE PRIMARE DHE SEKONDARE NË TRAJTIMIN E PËRMBAJTJEVE TË HISTORISË NË TEKSTET MËSIMORE TË KLASAVE V-IX TË SHFMU

ABSTRAKTI

Mësimdhënia është një proces i rëndësishëm dhe që kërkon kujdes e përkushtim të veçantë. Detyra e mësimdhënies kërkon hulumtim të metodave të përdorimit, për të arritur efektin e duhur në të kuptuarit e lëndës së historisë. Duke e konsideruar lëndën e historisë si një bazën e zhvillimit qytetar, është e rëndësishme që të kuptohen dhe të vlerësohen burimet historike. Duke pasur parasysh që mësimdhënësit kanë në fokus transmetimin e dijes tek nxënësit, atëherë është e rëndësishme që të praktikohen metoda efektive që nxënësit ta kuptojnë historinë dhe ndikimin që ka ajo në zhvillimin e tyre.

Qëllimi i këtij punimi është që të hulumtohet ndikimi i përdorimit të burimeve të historisë në mësimdhënien e historisë. Në bazë të këtij hulumtimi do të arrihen përfundime të sakta për përdorimin e burimeve të historisë, sa ndikojnë ato në mësimdhënien e historisë dhe rezultatet që arrihen për proceset historike përmes përdorimit të burimeve të historisë. Hulumtimi do të realizohet duke kërkuar përgjigjet në proceset e mësimdhënies së historisë në Kosovë. Po ashtu qëllim i hulumtimit është pasurimi i literaturës sa i përket përdorimit të burimeve primare dhe sekondare në mësimdhënien e historisë, duke i përdorur rekomandimet e arritura nga hulumtimi. Hulumtimi do të paraqes mënyrat sesi nxënësit do të arrijnë të vërtetësinë e informacionit për të krijuar argumentet të qarta përmes shfrytëzimit të burimeve primare dhe sekondare. Duke analizuar burimet primare dhe sekondare, do të shqyrtohet përdorimi i këtyre burimeve nga ana e mësimdhënësve gjatë trajtimit të përmbajtjeve të teksteve mësimore të lëndës së historisë. Përmes hulumtimit do të arrihen rezultatet e kërkuara për të vërtetuar hipotezat dhe pyetjet kërkimore të hulumtimit që kanë të bëjnë me përdorimin e burimeve primare dhe sekondare në trajtimin dhe interpretimin e teksteve mësimore nga ana e mësimdhënësve. Po ashtu hulumtimi do të ofroj rezultate edhe për interesimin e nxënësve në përdorimin e burimeve në të kuptuarit e lëndës së historisë.

Fjalët kyçe: burime, histori, mësimdhënie, primare, sekondare